



**ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS
TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS**



Oda e Avokatëve të Kosovës
Kosova Chamber of Advocates
Advokatska Komora Kosova

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

PRISHTINË
Janar 2010

Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, në Prishtinë, me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit afatgjatë, lidhin këtë

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

A. STATUSI I ETNITETEVE BASHKËPUNUESE:

Oda e Avokatëve të Kosovës [në vijim: OAK], është një organizatë e pavarur profesionale e avokatëve Kosovarë e themeluar me ligj. Misioni i Odës përfshinë edhe nxitjen e një qasje sa më të plotë dhe të barabartë të përfaqësimit ligjor për të gjithë personat pa marrë parasysh kushtet ekonomike dhe sociale. Edhe katëgoritë e veçanta përfitojnë nga aktivitetet e Odës për përforcimin e administrimit të drejtësisë, zgjerimin e kuptimit dhe respektimin e ligjit dhe të institucioneve ligjore.

Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është organizatë joqeveritare e jopartiake e bashkimit të lirë dhe të vullnetshëm të të gjithë luftëtarëve të UÇK-së. OVL të UÇK-së synon: njohjen dhe avancimin e statusit të luftëtarëve të UÇK-së, dëshmorëve, familjeve të tyre dhe mbrojtjes së dinjitetit dhe integritetit të tyre; ruan nderin, karakterin dhe idealin çlirimtar të luftës së UÇK-së; të ndihmojë luftëtarët e UÇK-së dhe familjet e tyre në realizimin e të drejtave të tyre dhe të ruajë, mbrojë e avansojë vlerat e shenjta të luftës çlirimtare.

B. QËLLIMI I MARRËVESHJES:

Me këtë Marrëveshje palët kanë për qëllim që të sigurojnë mbështetjen e qëndrueshme në çështjet e statusit dhe çështjeve të tjera ligjore për kategorinë e qytetarëve të përfaqësuar nga OVL të UÇK-së.

C. FORMATE BASHKËPUNIMIT:

I.

Palët Oda e Avokatëve të Kosovës - më tutje "OAK" dhe Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, më tutje "OVL të UÇK-së" dhe do të zhvillojnë format e bashkëpunimit në fushëveprimin e vet.

II.

Për këtë qëllim ata do të ndërtojnë lidhje të qëndrueshme në ofrimin e ekspertizës, përvojës dhe resurseve të Odës për kategorinë e qytetarëve të përfaqësuar nga OVL të UÇK-së.

III.

Oda në veçanti:

a)

Do të ofrojë angazhime të caktuara në lidhje me infrastrukturën ligjore për të siguruar procedura efektive dhe mekanizma përgjegjës për statusin dhe të drejtat e këtyre njerëzve.

b)

Përmirësimin dhe përmbylljen e infrastrukturës ligjore në lidhje me statusin juridik dhe të drejtat e dëshmorëve, veteranëve të luftës dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

c)

Përkrahja në hyrjen në profesionin dhe avancimin profesional të fëmijëve dhe anëtarëve të familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve, veteranëve të luftës dhe anëtarëve të familjeve të tyre, përmes lehtësirave për qasje në programeve të Odës për mentorimin e gjeneratave.

d)

Aktivitetet e ndryshme në dhënjen e ndihmës juridike, këshillave, rekomandimeve, njoftimit me ligjet pozitive dhe edukimin ligjor.

f)

Ndihmën e parë juridike, e cila do të përfshinte aktivitetet e komunikimit, udhëzimet fillestare, pastaj sistemin e kontaktimit të tyre të parë me avokatin.

D. AKTIVITETET E PËRBASHKËTA:

Palët do të mbështesin bashkëpunimin reciprok, ku do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta dhe bashkërisht do të realizojnë bashkëpunimin nga fusha e këtij Memorandumi.

E. IMPLEMENTIMI:

I.

Ky Memorandum fillon të implementohet nga palët nënshkruese në ditën e nënshkrimit.

II.

Palët do të formojnë nga një përfaqësues prej secilës shoqatë në afatin prej **7 (shtatë)** ditësh që do të caktojnë aktivitetet konkrete lidhur me ecurinë e këtij bashkëpunimi.

F. NËNSHKRIMI DHE HYRJA NË FUQI:

I.

Memorandumi hyn në fuqi dhe i obligon palët në momentin e nënshkrimit nga të palët.

II.

Palët zotohen se do t'i përmbushin obligimet që dalin nga ky Memorandum.

III.

Memorandumi është e përpiluar në katër ekzemplarë me përmbajtje të njëjtë, prej të cilave, pas nënshkrimit dhe protokolimit, nga dy ekzemplarë do t'i mbesin secilës palë.

IV.

Me autorizim që të pranojnë përgjegjësitë dhe të nënshkruajnë këtë Memorandum.

Në emër të:

Odës së Avokatëve të Kosovës,

Musa Xh.Dragusha, kryetar

Në emër të:

OVL të UÇK-ës

Muharrem Xhemajli, kryetar

Nënshkruar në Prishtinë,

Datë: 12. 01. 2010